

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6595
E shtunë, 30 prill 2022
çmimi 0.40 €

Rritja e pagës minimale prek mbi 100 mijë punëtorë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME, XHELAL SVEÇLA, KA RAPORTUAR PARA ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR ÇËSHTJE TË SIGURISË DHE MBROJTJES

SVEÇLA PËR SULMET NË VERI: POLICIA ËSHTË PËR LIGJSHMËRI NË ÇDO CEP TË KOSOVËS



Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka raportuar të premtën në Komisionin për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes lidhur me raportin vjetor të punës për vitin 2021. Ai ka folur edhe për sulmet e fundit ndaj Policisë së Kosovës në komunat veriore. Sveçla ka pohuar se sulmet ndaj policisë në veri janë për shkak të shtrirjes së ligjshmërisë dhe se këto sulme kanë prapavijë tjetër, për të ngjallur panik. Mirëpo, ai ka thënë se angazhimi i Policisë së Kosovës ka sjell stabilitet në vend.

Nuk është krim krijimi dhe udhëheqja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës



Shkruan: Kudusi LAMA



KOMUNAT PO SHQYRTOJNË MUNDËSINË T'I PADITIN MASHTI-N DHE MSH-në

FAQE 7

AKTUALE



SHPËRTHIME NË KIEV PAS TAKIMIT TË ZELENSKYT ME SHEFIN E OKB-së

HAXHI KRASNIQI SHPALLET USHTARI MË I MIRË I FSK-SË PËR VITIN 2022

MË 5 MAJ MBAHET SEANCA E RADHËS E KUVENDIT

EKONOMI



KONJUFCA FTON AFARISTËT GJERMANË TË INVESTOJNË NË KOSOVË

MINISTRI LATIFI THOTË SE ËSHTË GATI PËR MIRATIM LIGJI PËR SIGURIMIN SHËNDETËSOR

SPORT



DISTRIA FITON MEDALJEN E BRONZTË NË KAMPIONATIN EVROPIAN

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shpërthime në Kiev pas takimit të Zelenskyt me shefin e OKB-së



KIEV, 29 PRILL - Rusia goditi kryeqytetin ukrainas të Kievit menjëherë pas një takimi midis presidentit ukrainas Volodymyr Zelensky dhe sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, Antonio Guterres, të enjten në mbrëmje. Të paktën një person u vra dhe disa u plagosën, duke përfshirë disa të cilët u bllokuan nën rrënoja, sipas zyrtarëve të shpëtimt. Kryebashkiaku Vitali Klitschko

tha se distrikti në pjesën veriperëndimore të qytetit u godit dy herë, duke shkaktuar zjarre në të paktën dy ndërtesa të larta. Shpërthimet, të cilat dërguan shtëllunga tymi të zi në ajër, erdhën menjëherë pasi të dy udhëheqësit mbajtën një konferencë shtypi në të cilën Guterres dënoi mizoritë e kryera në qytete si Buça, ku u gjetën prova të vrasjeve masive të civilëve pasi Rusia u tërhoq.

Autoritetet thanë se shefi i OKB-së dhe ekipi i tij ishin të sigurt. Kjo u pa si një nga sulmet më të guximshme në Kiev që kur forcat ruse u tërhoqën nga kryeqyteti javë më parë. Shpërthimet erdhën ndërsa banorët po kthehen gjithnjë e më shumë në qytet. Kafenetë dhe bizneset e tjera janë rihapur dhe një numër në rritje njerëzish kanë dalë jashtë dhe kanë shijuar motin pranveror.

OKB-ja voton më 11 maj për zëvendësimin e Ruisë në Këshillin e të Drejtave të Njeriut

NJU-JORK, 29 PRILL - Asambleja e Përgjithshme e OKB-së do të votojë më 11 maj për një vend që do ta zëvendësojë Rusinë në organin kryesor të të drejtave të njeriut pas pezullimit të saj mbi akuzat për shkelje të tmerrshme nga ushtarët rusë në Ukrainë. Zëdhënësja e asamblesë, Paulina Kubiak, tha të enjten se Republika Çeke ishte kandidatja e vetme për vendin në Këshillin e të Drejtave të Njeriut prej 47 anëtarësh. Vendet në këshillin me bazë në

Gjenevë janë të ndara midis grupeve rajonale dhe një zëvendësim për Rusinë duhet të vijë nga një vend i Evropës Lindore. Pasi Asambleja e Përgjithshme pezulloi Rusinë, zëvendësambasadori i saj, Genadi Kuzmin, u tha anëtarëve të OKB-së se Rusia u tërhoq nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut përpara votimit. Zëdhënësi i Këshillit, Rolando Gomez, tha se duke u tërhequr, Rusia shmangu privimin e statusit

të vëzhguesit në organin e të drejtave. Që nga pushtimi i Ukrainës më 24 shkurt Rusia ka humbur vendin e saj në organe të shumta të OKB-së, duke përfshirë bordet ekzekutive të UN Women dhe agjencinë e OKB-së për fëmijë UNICEF, Komitetin për Organizatat Joqeveritare dhe Forumin e Përhershëm për Çështjet Indigjene. Rusia u pezullua këtë javë nga Organizata Botërore e Turizmit.



Mbi 3 000 njerëz humbën jetën në rrugët e migrantëve në vitin 2021



BRUKSEL, 29 PRILL - Më shumë se 3 000 refugjatë dhe migrantë vdiqën vitin e kaluar në rrugët detare përnjë Evropë. Gjithsej 1 924 të vdekur ose të zhdukur janë raportuar në rrugët nga Afrika e Veriut përgjatë Mesdheut, si dhe 1 153 midis brigjeve të Afrikës Perëndimore dhe Ishujve Kanarie, që i përkasin Spanjës, tha komisionari i lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR). Numri i të vdekurve dhe të zhdukurve është dyfish më shumë

se vitin e kaluar, tha të premtën një zëdhënësja e UNHCR-së në Gjenevë. "Deri më tani, këtë vit, 478 persona kanë vdekur në rrugët e migrantëve. Një numër i madh njerëzish tashmë, ndoshta, kanë vdekur duke ikur nga vendet e tyre në brigjet e Mesdheut dhe Atlantikut", tha zëdhënësja. Atje, shtoi ajo, ata janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të shfrytëzimit, abuzimit, skllavërimt dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut. "UNHCR paralajmëron se

paqëndrueshmëria e vazhdueshme politike dhe konfliktet, përkeqësimi i kushteve socio-ekonomike dhe ndikimi i ndryshimeve klimatike, mund ta rritin zhvendosjen dhe lëvizjet e rrezikshme", thuhet në deklaratë. Organizata dëshiron t'i mbrojë refugjatët dhe migrantët e tjerë përgjatë rrugëve të refugjatëve nga shfrytëzimi dhe trafikimi i qenieve njerëzore. Ajo po kërkon 163.5 milionë dollarë donacione nga qeveritë për programe në 25

Turqia akuzon Greqinë për shkelje të hapësirës ajrore

Ankara, 29 prill - Turqia akuzoi të premtën avionët luftarakë grekë për shkelje të hapësirës së saj ajrore mbi Detin Egje që, sipas burimeve turke të sigurisë, ka ndodhur 30 herë në 72 orë. Greqia dhe Turqia, aleatë të NATO-s, por rivalë rajonalë në Mesdheun lindor, shpesh përplasen për shkeljet e hapësirës ajrore në Egje. Avionët luftarakë grekë përpiqen rregullisht t'i përgjojnë avionët turq që hyjnë në atë që Athina e konsideron hapësirën e saj

ajrore, duke u përfshirë herë pas here në përlëshje të rrejshme në ajër. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme turke, Tanju Bilgiç, i akuzoi forcat ajrore greke për kryerjen e "fluturimeve me qëllim të nxitjes së provokimeve pranë bregdetit turk" dhe për "shkeljen e hapësirës ajrore turke" disa herë në periudhën nga e marta deri të enjten. Ankaraja u përgjigj "në përputhje me rregullat e saj të angazhimit", shtoi ai. Burimet turke të sigurisë

thanë se të mërkurën u regjistruan 22 shkelje të hapësirës ajrore dhe se forcat ajrore turke u kundërpërgjigjen çdoherë. Këto burime kritikuan "veprimet e paligjshme, provokuese dhe agresive të Greqisë në Detin Egje". Kryeministri grek Kyriakos Mitsotakis tha të enjten se e kishte informuar sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, për "sjelljen e fundit provokuese të forcave të armatosura turke", të cilat shkelin hapësirën ajrore greke dhe



"fluturojnë në mënyrë të rrezikshme" mbi ishujt grekë. Turqia i ka hedhur poshtë kritikën si "të pabaza" dhe "të

papajtueshme me agjendën e fundit pozitive dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë".

Haxhi Krasniqi shpallet ushtari më i mirë i FSK-së për vitin 2022

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 PRILL - Ceremonia e përmbylljes së garës ndërkombëtare tradicionale "Ushtari më i mirë 2022" është mbajtur të premten në kazermën e FSK-së "Adem Jashari" në Prishtinë. Me këtë rast, ushtari Haxhi Krasniqi është shpallur ushtari më i mirë 2022 i FSK-së dhe, pas tij, janë radhitur ushtarët Ejdon Mulaku dhe Qëndrim Asllanaj.

Ndërsa ushtari nga Kanda, Simon Buies, është shpallur ushtari më i mirë ndërkombëtar, i përcjellë nga ushtari amerikan Jaron Springer dhe ushtari turk Oliver Verrete.

Zëvendësministri i Mbrojtjes, Shemsi Sylja, i cili ishte i pranishëm në këtë ceremoni, ka theksuar se qëllimi primar i FSK-së në garën e ushtarit më të mirë është rritja e aftësive ushtarake, fitesit dhe zgjedhja e më të mirit.

Ai ka shtuar se kjo garë njëjavore, që tashmë është tradicionale, promovon vlerat, profesionalizimin dhe ndihmon pjesëmarrësit t'i shkëmbejnë përvojat me kolegët e vendeve partnere. "Pjesëmarrja e garuesve nga ushtritë e vendeve partnere në këtë garë e dëshmon shkallën e lartë të bashkëpunimit me vendet partnere dhe që FSK-ja është forcë profesionale e disiplinuar, motivuar dhe kontribuuese e sigurisë në regjion dhe me gjerë", ka thënë ai.

Më tej, zëvendësministri Sylja ka shtuar se Ministria e Mbrojtjes dhe gjithë Qeveria e Republikës së Kosovës, si përgjegjëse e sigurisë dhe mbrojtjes së vendit, ka objektiv kryesor ndërtimin e forcave sipas standardeve të vendeve të NATO-s.

Ndërsa shefi i Stafit të Shtabit të FSK-së, gjeneralbrigade Jeton Dreshaj, ka thënë se FSK-ja është duke ngritur dhe zhvilluar ushtarë



me karakter dhe të devotshëm në mbajtjen e vlerave dhe standardit më të lartë fizik dhe psikik.

Në garën "Ushtari më i mirë 2022" morën pjesë 39 garues nga Kosova,

Shqipëria, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Kanadaja, Iowa (ShBA-ja) dhe Turqia si pjesë e KFOR-it.

Pjesëmarrësit garuan në disiplinat si: testi fizik, njohuri të

përgjithshme, gjuajtje me armë të gjata, navigim tokësor, kalimi i poligonit të besueshmërisë, hedhja e granatës, ndihma e parë, vëzhgimi i terrenit dhe marshimi.

Komunat po shqyrtojnë mundësinë t'i paditin MASHTI-n dhe MSh-në

Prishtinë, 29 prill (ER) - Komunat janë duke e shqyrtuar mundësinë që t'i paditin Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë e Inovacionit (MASHTI-n) dhe Ministrinë e Shëndetësisë (MSh-në) si ministri nënshkruese të Kontratave Kolektive, sepse këto kontrata janë nënshkruar pa mbulueshmëri financiare, ka njoftuar Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK). "Komunat nuk janë kundër Kontratave Kolektive, por mbulueshmëria financiare dhe borxhet që burojnë nga këto kontrata duhet të mbulohen nga niveli qendror sepse ato janë nënshkruese të këtyre kontratave e jo komunat. Pra, komunat, edhe pse nuk janë nënshkruese të kontratave kolektive, po obligohen t'i mbulojnë shpenzimet dhe borxhet nga nënshkrimi i këtyre kontratave duke iu krijuar komunave shpenzime të mëdha të procedurave gjyqësore/përmbartimore", ka njoftuar AKK-ja.



Sipas këtij njoftimi, këto kontrata kanë dëmtoar jashtëzakonisht shumë buxhetin e komunave e të cilat kanë ndikuar edhe në mosrealizimin e shumë

projekteve kapitale e të cilat projekte ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarit. "Duke marrë parasysh se në takimin dyditor të Komisionit të

Granteve, në të cilin janë përcaktuar grantet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2023 dhe orientimet për vitet 2024-2025, nuk është parë që

qeveria ka ndonjë vullnet për zgjidhje të kësaj çështje. Në këtë drejtim po mendohet nga komunat të shfrytëzohet mundësia e ngritjes së një padie të përbashkët për ministrinë nënshkruese të kontratave kolektive e që janë MASHTI dhe MSh. Në këtë takim të Komisionit të Granteve ka qenë i pranishëm edhe ministri i Ministrisë së Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, i cili me votën e tij ka dalë kundër kërkesave të komunave që borxhet dhe obligimet financiare për zbatimin e Kontratave Kolektive të mbulohen nga niveli qendror", ka njoftuar AKK-ja. Ministri Krasniqi në takimin e mëhershëm të përbashkët me kryetarët e komunave ishte zotuar që do të angazhohet për zgjidhjen e këtij problemi, mirëpo në Komisionin e Granteve ai ka votuar pro vendimit të qeverisë që të vazhdohet me masat e njëjta edhe në të ardhmen.

Më 5 maj mbahet seanca e radhës e Kuvendit

PRISHTINË, 29 PRILL (ER) - Kryesia e Kuvendit të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur të premten, ka vendosur që seanca e radhës e Kuvendit të mbahet të enjten, më 5 maj 2022, në orën 10:00.

Pas deklarimeve jashtë rendit të ditës dhe pyetjeve parlamentare, në rend dite të kësaj seance do të jenë: propozimi i dy kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën

Kushtetuese, shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficentit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore, shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e

Ligjit nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, emërimi i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, formimi i komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të RTK-së, si dhe debati parlamentar për punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës në vitin e parë të mandatit të saj.





MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME, XHELAL SVEÇLA, KA RAPORTUAR PARA ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR ÇËSHITJE TË SIGURISË DHE MBROJTJES

Sveçla për sulmet në veri: Policia është për ligjshmëri në çdo cep të Kosovës

Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka raportuar të premtën në Komisionin për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes lidhur me raportin vjetor të punës për vitin 2021. Ai ka folur edhe për sulmet e fundit ndaj Policisë së Kosovës në komunat veriore. Sveçla ka pohuar se sulmet ndaj policisë në veri janë për shkak të shtrirjes së ligjshmërisë dhe se këto sulme kanë prapavijë tjetër, për të ngjallur panik. Mirëpo, ai ka thënë se angazhimi i Policisë së Kosovës ka sjell stabilitet në vend

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 PRILL - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka thënë të premtën se autoritetet po punojnë intensivisht për hetimin e sulmeve të fundit ndaj Policisë së Kosovës në komunat veriore. Komunitat në veri të Kosovës, si Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zvečan dhe Leposaviq, janë të banuara me shumicë serbe. Gjatë një raportimi për punën e tij para deputetëve, anëtarë të Komisionit për Çështje të Sigurisë

dhe Mbrojtjes, Sveçla ka thënë se gjashtë sulmet ndaj policisë në javët e fundit "kanë sjell një ndjenjë të pasigurisë te qytetarët atje".

Duke u përgjigjur në pyetjet e shumta të komisionit, ministri Sveçla ka pohuar se sulmet ndaj policisë në veri janë për shkak të shtrirjes së ligjshmërisë dhe se këto sulme kanë prapavijë tjetër, për të ngjallur panik. Mirëpo, ai ka thënë se angazhimi i Policisë së Kosovës ka sjell stabilitet në vend. "Policia është për ligjshmëri në çdo cep të Kosovës, për të siguruar dhe mbrojtur qytetarët

pa kurrfarë dallimi", ka thënë ministri i MPB-së.

Në periudhën 13-26 prill Policia e Kosovës ka regjistruar gjashtë sulme ndaj saj.

Në sulmet e njëpasnjëshme ndaj policisë, sipas autoriteteve, janë përdorur iriqë metalikë, gurë, granata dore, armë automatike dhe mjete piroteknike.

Sipas Sveçlës, lidhur me këto sulme janë rritur aktivitetet hetimore në zonën e komunave veriore të banuara me shumicë serbe. Megjithatë, ai nuk ka përmendur nëse deri më tani është identifikuar ndonjë i

dysuar për këto sulme. "Unë jam optimist që për një afat shumë të shpejtë do të kemi rezultatet e duhura [të hetimit] në këtë fushë", ka thënë Sveçla.

Sveçla, duke paraqitur në detaje punën dhe aktivitetet e këtij institucioni për vitin paraprak, ka thënë se Ministria e Punëve të Brendshme vitin e parë qeverisë e ka përmbyllur me suksese të dukshme, duke përmendur në vijim një sërë veprimesh konkrete.

Ai ka thënë se janë të angazhuar maksimalisht që institucionet e sigurisë të jenë në nivel. Duke paraqitur në detaje statistikat e operacioneve policore, ministri Sveçla ka theksuar se janë goditur mbi 50 grupe kriminale, duke shtuar se ka zbulim substancial të kontrabandës të të gjitha llojeve. Ai ka thënë se përparim është shënuar edhe në fushën e parandalimit të krimit të

organizuar dhe luftës kundër korrupsionit.

Në vijim anëtarë të komisionit shprehën shqetësimet e tyre lidhur me ngjarjet në veri, ndërkaq kërkuan sqarime të shumta nga ministri Sveçla për çështje të ndryshme që kishin të bënin me fushën e sigurisë. Disa nga ta e përgëzuan ministrin për shtrirjen e autoritetit në veri.

Ndërkaq, lidhur me reciprocitetin, ministri Sveçla tha se reciprociteti me targa është menaxhuar me sukses. Në vijim ai foli edhe për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit, agjendën evropiane, marrëveshjet ndërkombëtare, konkursin për policë, përfshirjen në rekrutim të pjesëtarëve nga komunitetet e tjera, numrin e operacioneve policore, Ligjin për Pagat, çështjen e rrjedhës së informacionit, aplikimin në Interpol dhe çështje të tjera.

Gjyqtari Stensland u rizgjodh kryetar i Dhomës së Specializuar i Gjykatës Kushtetuese të Speciales

HAGË, 29 PRILL (ER) - Gjykatësi Vidar Stensland është rizgjodhur kryetar i Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese të Dhomave të Specializuara të Kosovës është bërë me dije në një njoftim të

publikuar në faqen e gjykatës. "Në një vendim të lëshuar më 25 prill 2022, gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (DhSGJK) vendosën ta zgjedhin gjykatësin Vidar

Stensland gjykatës kryesues të DhSGJK-së, në përputhje me Rregulloren e Punës së DhSGJK-së, për një mandat njëvjeçar, i cili fillon më 1 qershor 2022", thuhet në këtë njoftim.



Rritja e pagës minimale prek mbi 100 mijë punëtorë

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 29 PRILL - Instituti GAP ka organizuar të premten konferencë për medie në të cilën ka paraqitur raportin "Kush ndikohet nga rritja e pagës minimale në Kosovë?"

Sipas këtij raporti, përcaktimi i nivelit të ri të pagës minimale në Kosovë në vitin 2022, e cila nuk është ndryshuar që nga viti 2011, është ndërlidhur me një periudhë të ngritjes së ndjeshme të çmimeve të produkteve bazë. "Qeveria e Kosovës, me një projektligj të ri, po synon ta shkëpusë pagën minimale nga tri pensione sociale si dhe t'i hapë rrugë vetes që ajo ta përcaktojë pagën minimale në rast se nuk arrihet konsensus në mes të qeverisë, sindikatave të punonjësve dhe përfaqësuesve të bizneseve në Këshillin Ekonomiko-Social. Qeveria veçse ka propozuar që paga minimale të bëhet 264 euro bruto", thuhet në raportin e GAP-it.

Të gjeturat e këtij raporti, i cili bazohet në të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës, tregojnë se rritja e pagës bruto në 264 euro prek rreth 30 % të tregut të punës apo rreth 105 mijë punonjës. "Nga ta, rreth 30 mijë punonjës (28 %) janë të punësuar në sektorin e tregtisë me



shumicë dhe pakicë; 16 mijë (15 %) në industrinë përpunuese; rreth 12 mijë (11 %) në gastronomi; rreth 11.8 mijë (11 %) në aktivitetet financiare dhe të sigurimit; 8.5 mijë (8 %) në ndërtimtari etj", theksohet në raport.

Mbi 94 % e të prekurve nga rritja e pagës minimale janë punonjës të

sektorit privat. "Përveç një numri të punonjësve te sektori i sigurisë, rritja e pagës minimale nuk e prek fare sektorin publik. Me rritjen e pagës minimale në 264 euro, raporti në mes të pagës minimale dhe mediane rritet ndjeshëm, nga 43 % në 66 %", thuhet në raportin e GAP-it.

Marrë parasysh ndikimin që mund

të ketë rritja e pagës minimale në punësim, sidomos te të rinjtë apo te punonjësit me më pak shkollësi, siç tregojnë gjetjet e studimeve të ndryshme, nivele të tjera më të larta të pagës minimale sikurse prej 300, 350 apo 400 euro, e prekin një numër të lartë të punonjësve në tregun e punës dhe mund t'i dëmtojnë qytetarët dhe

ekonominë e Kosovës, meqë sektorët më të prekur janë edhe sektorët me shkallën më të lartë të informalitetit në vend.

Në këtë raport është theksuar se, krahas rritjes së pagës minimale, është e rëndësishme që të rriten kapacitetet zbatuese dhe monitoruese lidhur me implementimin e pagës minimale.

Lajçaku: Më 13 maj do të bisedohet për targat



PRISHTINË, 29 PRILL (ER) - I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajčák, përmes një shkrimi në "Twitter", ka njoftuar se ka biseduar me kryenegociatorët e Kosovës dhe të Serbisë në dialogun e Brukselit, Besnik Bislimi dhe Petar Petkoviç, dhe më 13 maj do të vazhdojnë diskutimet për një zgjidhje për targat. "Më vjen mirë të njoftoj se pas konsultimeve të mia me dy kryenegociatorët dhe sot, ramë dakord t'i vazhdojmë diskutimet tona për gjetjen e një zgjidhjeje të përhershme për çështjen e targave në Bruksel më 13 maj", ka thënë Lajčák.

Më 21 prill, në Bruksel,

kryenegociatorët në dialogun Kosovë - Serbi, Besnik Bislimi dhe Petar Petkoviç, ishin takuar për të diskutuar për një marrëveshje të përhershme për targat, pasi që marrëveshja e përkohshme e arritur më 30 shtator të vitit të kaluar skadoi më 21 prill.

Por, në takimin e 21 prillit ata dështuan të arrinin një marrëveshje të përhershme për targat dhe marrëveshja paraprake e përkohshme vazhdoi të mbesë në fuqi.

Sipas marrëveshjes së përkohshme, automjetet e të dyja vendeve, gjatë qarkullimit në territoret përkatëse, vendosnin letra të bardha ngjitëse mbi simbolet shtetërore në targa.

Rritet pak numri i të infektuarve me Covid

PRISHTINË, 29 PRILL (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se pas 619 testeve, 29 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes.

Të premten janë shëruar edhe tre qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 224 473. Në total numri i rasteve aktive është 441.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 157 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 825 998 doza të vaksinës. Deri më sot 821 983 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 101 471 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



“NDËRMARRJE E PËRBASHKËT KRIMINALE” APO LUFTË ÇLIRIMTARE E KOSOVËS? (7)

Nuk është krim krijimi dhe udhëheqja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës



Shkruan: Kudusi LAMA

Kam lexuar se në kuptimin penal - juridik “Ndërmarrja e Përbashkët Kriminale nënkupton forma të bashkëkryerjes sistematike dhe gjerësisht të përhapura të veprave penale (krimit), me këto elementë: 1. që në kryerjen e krimit të kenë marrë pjesë më shumë ekzekutues; 2. që ata individë në grup kanë synim dhe qëllim të përbashkët; 3. që synimi ose qëllimi i përbashkët paraqet veprë penale (krim) të paraparë sipas ligjit, 4. që kryesit e veçantë (individualisht) të veprave penale kanë qëllim të përbashkët; 5. që i akuzuari konkret ndaj të cilit zhvillohet gjykimi, ka marrë pjesë në atë ndërmarrje të përbashkët dhe ka ‘kontribuar’ dukshëm në kryerjen e krimit; 6. që personat të cilët kanë marrë pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale duhet të identifikohen me ndonjë strukturë, emër, kategori apo grup të cilit i përkasin (ushtarak, policor, paraushtarak, administrativ) apo çfarëdo grupi tjetër të identifikueshëm”.

Po të merren në analizë këto elemente, të cilët i kam lexuar diku të shprehura nga një jurist, del qartë, se ata burra të luftës që mbahen peng në Hagë, duhet të kthehen në shtëpi me pafajësinë dhe duke u kërkuar falje.

1. Sepse ata nuk kanë krijuar një ndërmarrje të përbashkët kriminale, pasi nuk mund të gjendet asnjë dokument që t'i fajësojë sepse nuk ekziston;

2. sepse ata nuk kanë marrë pjesë personalisht në asnjë akt kriminal;

3. sepse nuk ekziston asnjë dokument që të përcaktojë synimin ose qëllimin e përbashkët për të kryer veprime a veprimtari që paraqesin veprë penale (krim) të paraparë sipas ligjit, vetëm nëse do të konsiderohet krim që kanë krijuar dhe udhëhequr Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës për ta çliruar vendin nga pushtimi serb;

4. sepse dokumenti që të vërtetojë se këta burra të kenë ndërmarrë veprime kriminale për të plotësuar detyrime për mision të përbashkët kriminal;

5. sepse nuk ka asnjë veprim që i ngarkon këta burra me përgjegjësi kriminale, si pjesëmarrës ose kontribuues në kryerje krimesh;

6. sepse ata janë të identifikuar me një strukturë, por që ajo nuk ishte një Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale, por një ndërmarrje e përbashkët çlirimtare dhe quhej Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe që u bë bashkëluftëtare e NATO-s, SHBA-ve dhe gjithë shteteve të zhvilluara të botës moderne, të cilët erdhën për të luftuar përkrah saj në Luftën Çlirimtare të Kosovës.

Dhe në fund, sepse unë jam i bindur se, askush nuk mund të dënohet në qoftë se “nuk ka planifikuar, nxitur, urdhëruar, kryer ose në ndonjë mënyrë tjetër ka ndihmuar dhe ka dhënë mbështetje për planifikimin, përgatitjen ose ekzekutimin e këtij krimi, ...”. Prandaj unë kërkoj: ku janë planet? Si është bërë organizimi? Si janë vënë detyrat? Cila ka qenë struktura e organizuar dhe e planëzuar për të kryer krime? Të tilla as nuk ka pasur në UÇK e as nuk ka ku të gjenden, veçse në qoftë se merrni si model planet e programet dhe strukturat përkatëse kriminale të Serbisë, që kanë vepruar në Kosovë dhe kanë bërë krime të mëdha që kanë tentuar të zhdukun një popull. Dhe plane të tilla ka pasur ushtria jugosllave e cila solli në Kosovë 72 mijë trupa, me të gjitha llojet e armëve e të mjeteve ushtarake për veprime tokësore dhe ajrore; ka pasur policia jugosllave e serbe të cilat sollën në Kosovë 12 forca policore; kanë pasur forcat paramilitare serbe të cilat sollën në Kosovë 8 mijë trupa paramilitare; ka pasur qeveria serbe e cila solli në Kosovë 5 mijë forca kriminale, që i liroj nga burgjet vetëm për të bërë krime në Kosovës, duke u falur dënimin e mbetur; ka pasur qeveria serbe e cila armatosi në Kosovë 63 mijë qytetarë serb të Kosovës, me detyrë për të vlarë çdo qytetar shqiptar të Kosovës që do t'u zinte syri. Këta po. Kanë pasur plane. Por këta nuk quhen kriminelë. Kriminelë quhen luftëtarët pse kanë çliruar atdheun e tyre dhe i kanë sjellë lirinë popullit të tyre. Por që kanë prishur interesat e Serbisë

të cilën ata që kanë fuqi në Europë e duan më shumë se Kosovën. Prandaj Kosova mund të sakrifkohet, mund të përdhuhet edhe nga Europa, mjaft që Serbia të mbetet e kënaqur. E turpshme!

Si do ta tregojmë historinë e luftës çlirimtare të Kosovës?

Çfarë do t'u themi të rinjve në Kosovë? Çfarë do t'u themi fëmijëve në të sotmen dhe të ardhmen? Si do të duhet ta tregojmë historinë e luftës çlirimtare të Kosovës? Si do ta portretizojmë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës? Si do t'i quajmë luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës? Si do t'i quajmë dëshmorët e luftës çlirimtare të Kosovës? Tashmë për qejfin e Serbisë dhe të gjithë atyre që bëjnë politikën e saj vlen të thuhet se: historia e luftës çlirimtare të Kosovës, ishte një histori krimesh dhe një histori kur u prish lumturia që kishte krijuar Serbia si pushtuese e kolonizatorë në Kosovë; që Ushtria Çlirimtare të Kosovës, ishte një bandë kriminelësh, që krijuan një ndërmarrje të përbashkët kriminale, të cilës i vunë emrin Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe në përbërje të të cilës krijuan programe kriminale, duke u marrë me trafik droge; me trafik armësh; si dhe me therje njerëzish për t'u marrë trutë,

zemrat, veshkat, mëlçitë, mushkri etj., për t'i trafikuar për transplantime, veçse këto therje njerëzish i bënin në male nëpër stane dhe transportin e organeve të tyre për trafikim e bënin me kuaj e me gomarë; luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës do të themi se ishin të gjithë kriminelë të rrezikshëm dhe se ata që sot janë gjallë në Kosovë e nëpër botë duhet të mbahen nën vëzhgim, sepse janë të rrezikshëm, prandaj edhe shoqëria me ta duhet të jetë e kufizuar; dëshmorët e luftës çlirimtare të Kosovës, do të tregojmë se ishin disa kriminelë që gjatë kryerjes së krimeve disa ranë nëpër humnera, kurse të tjerët u vranë me njëri tjetrin duke ndarë pasuritë që përfitoheshin gjatë kryerjes së krimeve.

Besoj se me këtë histori të re për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, do të jenë shumë të kënaqur: Serbia, përkrahësit e Serbisë, të dashurit e Serbisë, si dhe të gjithë shqiptarët e dashuruar me Serbinë ose të skllavëruar prej Serbisë.

Kështu do të ndodhë nëse nuk jemi serioz, nëse nuk bëjmë atë që kërkohet nga ne, për të mos lejuar të na helmohet historia jonë, e cila është realisht histori e dëlirë. Kështu do të ndodhë, sepse gjykimet në Hagë po tentojnë të na e dënojnë luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, po tentojnë të na e kriminalizojnë rrugën e luftës drejtë lirisë dhe lirinë e fituar, po

tentojnë ta bëjnë fajtorë Kosovën përballë Serbisë, po tentojnë të krijojnë një fakt të paqenë për të krijuar historinë se në Kosovë kanë vepruar dy ndërmarrje të përbashkëta kriminale përballë njëra tjetrës. A vërtetë ka njëri me mend në kokë, që mendon dhe beson se mund të krijohet një gjendje dhe një histori e tillë? Jo, kurrë!

Nuk ndodhë, jo se nuk dua unë a nuk duan shqiptarët, por nuk ndodhë sepse nuk mund të ndodhë, pasi ka mashtrime, ka shpifje, por ka edhe të vërtetë dhe e vërteta është me ne, është me shqiptarët, është me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, është me luftën e drejtë të saj, është në bindjen e luftëtarëve dhe është me gjakun e dëshmorëve të atdheut.

Sepse është e vërteta, se është njohur që është zhvilluar një fushatë dhune kundër shqiptarëve në Kosovë dhe se kjo fushatë është zhvilluar nga forcat e ushtrisë, policisë, paramilitare e kriminale dhe e serbëve qytetar të Kosovës të armatosur, me planëzimin dhe nën drejtimin e pandërprerë të gjithë hierarkisë shtetërore të Jugosllavisë së mbetur dhe Serbisë, të cilat ishin përgjegjëse për vrasjet masive të qytetarëve shqiptarë të Kosovës, përdhunimin masiv të grave dhe vajzave shqiptare, si dhe dëbimin masiv deri në 75 për qind të civilëve shqiptarë të Kosovës nga shtëpitë e tyre dhe nga territori i Kosovës për në shtetet fqinje, duke u marrë e grisur çdo dokument identiteti dhe çdo dokument pronësie në Kosovë, që ata të mos kishin asnjë mundësi për t'u kthyer më

në shtëpitë e tyre. E gjithë kjo me synimin për të ndryshuar përbërjen demografike të Kosovës, nga me mbi 90 për qind shqiptare, për ta kthyer në një popullsi me shumicë serbe. Pra për ta kolonizuar përfundimisht, duke realizuar atë që është tentuar të bëhet me rreth 30 programe të zhdukjes së shqiptarëve prej dy shekujsh.

Të jemi krenar për Ndërmarrjen e Përbashkët Çlirimtare - Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës - që kemi krijuar si komb

Unë e di se rruga e luftës për liri është sa e vështirë aq edhe e gjatë. Ashtu sikurse di që sot ne e kemi frontin e luftës në Hagë. Prandaj edhe të gjithë duhet të jemi krenar për atë Ndërmarrje të Përbashkët Çlirimtare - Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës - që kemi krijuar si komb, pavarësisht se një pjesë të atyre që e krijuan dhe e udhëhoqën në luftë, sot po përballen me akuzat të montuara kriminale. Por Kosova e ka për detyrë të mos dobësohet, të mos ulë kokën. Është detyrë e saj të bëhet monolite përballë furtunës, të mos lejojë t'i nëpërkëmbet dinjiteti, sepse burrat që ka në Hagë do të kthehen me pafajësinë, por ata kanë nevojë edhe për ne, ata nuk mund ta bëjnë luftën vetëm, atyre e kemi për detyrë t'u rrimë pranë, t'i mbështesim, që ta dinë se nuk janë vetëm.

Si dje në luftë, ashtu edhe sot në paqe, duhet të jemi të kthjelltë, të jemi bashkë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës e kishte bazën në

qytetarët shqiptar të Kosovës, aty e kishte forcën, aty e kishte mbështetjen, aty e kishte moralin, aty e kishte gjakun, aty e kishte shpresën, prandaj edhe ishte ushtri e fortë, e disiplinuar dhe që luftonte me vetëmohim. Ashtu sot, populli i Kosovës duhet ta marrë në mbrojtje ushtrinë e tij, luftën e tij, historinë e tij, lavdinë e tij.

Përfundim

Kam shkruar më sipër nëse vërtetë mendon e beson kjo prokurori dhe gjykatë se mund të vazhdojnë të bëjnë si të duan dhe jo atë detyrë që kanë me ligj? A mundet vërtetë në kohët moderne një gjykatë e prokurori speciale në sy të gjithë botës, në vend që të bëjnë punë drejtësi ndërmarrin veprime politike? A mendojnë ata se vërtetë nuk ka kush u kërkon llogari? A ndihen ata vërtet zotë mbi fatet dhe historinë e Kosovës? Unë jam i bindur se nuk ka asnjë zot tjetër përveç Zotit që na ka krijuar. A do të vijë një ditë që kjo prokurori e gjykatë të japin llogari për këtë shkelje të ligjit në sy të gjithë botës? Unë mendoj se po. Nëse ata mendojnë se nuk vjen ajo ditë, e kanë gabim. Thashë që historia ecën vetëm përpara, nuk ka për të prapaktim. Prandaj sado të përpiqen këta prokurorë e gjykatës, nuk mund t'ia lëshojnë hijen e turpshme të kriminit as Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, as Kosovës, as luftëtarëve të lirisë së Kosovës. Gjithçka do të mbetet mbi ta. Por për t'i ndihmuar, dua t'i pyes, a e dinë prokurorët dhe gjykatësit e gjykatës speciale për krimet e supozuara të Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës, se në vitin 2020, në Beograd është publikuar libri "Gjenocidi shqiptar kundër serbëve në shekullin 20"? Nëse nuk e dinë, ua rekomandoj ta lexojnë. Aty do të gjejnë edhe shumë gjëra të tjera, që do ta pasurojnë njohjen e tyre për atë që kanë dëshirë të informohen.

Megjithëse ndoshta unë jam i vonuar, se ata prokurorë dhe ajo gjykatë furnizimin e informacion e merr nga Beogradi. Dhe atje ka ushqim të bollshëm për ta, sepse serbët po e kanë përkushtimin dhe fuqinë të botojnë libra në vijimësi kundër shqiptarëve edhe kur nuk kanë asnjë fakt, por duke i improvizuar dëshmitë. Ky libër i serbëve që po ju rekomandoj është akuzues për shqiptarët ashtu siç doni Ju dhe është i përkthyer në shumë gjuhë të botës. Prandaj edhe kjo fushë është e lirë për t'u shfrytëzuar sepse edhe këtë libër, si edhe të tjerët i financon me dorë të lirë pa u kursyer shteti i Serbisë.

Por dua të tërheq vëmendjen: Këto ditë u ballafaquam me deklarin se Serbia kishte ndërmarrë hapa me shërbimin e fshehtë të saj për të vrarë zotëri Dick Marty-n, me qëllim që t'ua lerë fajin shqiptarëve.

Unë nuk dyshoj aspak në faktin që Serbia bën plane dhe veprime të tilla, sepse është provuar shumë herë.

Por ajo që nuk kuptoj unë është se përse Serbia bën plane për t'i larë duart me Dick Marty-n? Çfarë ka ndodhur mes tyre? Sepse nëse ka një njeri që ka bërë krim personalisht për hatër të Serbisë, ky është Dick Marty. Ky njeri që për hatër të Serbisë dhe për interesat e tij personale bëri

një krim shumë të madh, si do të vritej nga serbët?

Këtu duken dy pamje:

Së pari; ka shumë mundësi, që Serbia duke e ditur se Dick Marty e ka kryer detyrën dhe e ka marrë shpërblimin për krimin që ka kryer, duke pasur frikë se mund të thirret si dëshmitarë në gjykatën e Hagës përballë luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe mund të bënte ndonjë deklarin të padëshirueshëm, menduan që ta heqin qafe njëherë e mirë dhe njëkohësisht të akuzonin shqiptarët si kryes të kësaj vepre dhe të ndizet edhe njëherë flaka e mashtrimit kundër Kosovës. Pra duke vrarë dy zogj me një gur, si i thonë.

Së dyti; mund edhe që Dick Marty, duke e pasur të qartë krimin që ka bërë dhe duke e parë dështimin e krijesës së tij, të krijojë situata të tilla vetë, që të krijohet mundësia e fshehjes së identitetit, që t'i kalojë vitet që i kanë mbetur në qetësi, pasi tashmë pasuri ka vënë mjaft.

Cilado pamje që të jetë, për mua është pamje e shëmtuar. Është pamje që tregon se e drejta e Luftës Çlirimtare të Kosovës dhe pastërtia e saj filloj tashmë të shfaqet. Serbia planifikon të likuidojë argatin e saj që e ka paguar me të shtrenjtë, ky është hapi i parë drejtë të vërtetës.

Por as Serbia as Dick Marty nuk besoj se kanë për të dalë pa u lagur nga kjo situatë.

Ajo që ka rëndësi është e ardhmja e sigurt e pastrimit të të gjithë llumrave që hodhën, që po hedhin dhe përpiqen të hedhin mbi Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, mbi luftën e saj dhe mbi luftëtarët e saj. (Fund)



Ekzekutohen nga 100 euro shtesë për punëtorët e sektorit publik

PRISHTINË, 29 PRILL (ER) - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka bërë me dije të premten se janë ekzekutuar shtesat prej 100 eurove për sektorin publik. Murati në një konferencë për medie ka thënë se ka nënshkruar marrëveshje me 39

organizata që e kanë si veprimtari edhe shpërndarjen e pakove ushqimore ku, siç tha ai, do të ndahen rreth 34 mijë sosh në vlerë prej 1.7 milionë eurosh. Po ashtu, Murati ka bërë me dije se në kuadër të pakos është ndarë mbështetja shtesë e 280

mijë pensionistëve, si dhe është shpërndarë dyfishi i skemës sociale. Ai ka treguar se më 5 maj do të hidhet në votim edhe ndryshim plotësimi i Ligjit për Rritjen e Pagës Minimale në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës.



Konjufca fton afaristët gjermanë të investojnë në Kosovë

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 29 PRILL - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka takuar të premten një grup të afaristëve nga Gjermania të cilët janë duke qëndruar për vizitë në Kosovë. Gjatë bashkëbisedimit me afaristët gjermanë, Konjufca ka thënë se Kosova e shihet Gjermaninë si partnere të rëndësishme për investime dhe

ka vlerësuar se nëpërmjet legjislacionit mund të kontribuohet për ardhjen e investitorëve të huaj në Kosovë. Në takim kreu i Kuvendit ka përmendur edhe ndihmën që Gjermania i ka ofruar popullit të Kosovës gjatë viteve nën okupim të regjimit serb dhe gjatë luftës së vitit 1999. Konjufca ka theksuar domosdoshmërinë që të krijohen vende pune në Kosovë, prandaj partneriteti me Gjermaninë është i rëndësishëm. "Papunësia në

Kosovë tradicionalisht ka pasur një përqindje bukur të lartë. Pikërisht për këtë arsye edhe migrimi është shumë i madh. Është e domosdoshme për ne që të krijojmë vende të punës në Kosovë, por për ta arritur këtë është i nevojshëm absorbimi i investimeve në vendin tonë, prandaj ju shohim si partnerë shumë të rëndësishëm", ka thënë kryeparlamentari Konjufca. Para afaristëve gjermanë, Konjufca ka theksuar se të gjitha

vendet demokratike duhet të jenë sa më të bashkuara në vitet e ardhshme në mënyrë që të tejkalohen krizat të cilat do të jenë si pasojë e agresionit të Rusisë në Ukrainë. "Agresioni i Rusisë në Ukrainë po tregon se në vitet e ardhshme e gjithë bota do të përballet me një krizë e cila do ta prekë edhe vendin tonë, por së bashku do ta kalojmë çdo sfidë", ka thënë Konjufca. Kryesuesja e delegacionit të afaristëve gjermanë, Sarna Roser,

duke folur për përparimin e Kosovës në aspektin ekonomik, ka theksuar se kjo vizitë do t'i nxisë afaristët e rinj që të vijnë të investojnë në Kosovë. Ajo ka shtuar se gjatë vizitës do të takohen edhe me përfaqësues të tjerë të institucioneve dhe përfaqësues të bizneseve të Kosovës për t'i parë mundësitë e investimeve në Kosovë. Në këtë takim ishte i pranishëm edhe ambasadori i Republikës së Kosovës në Gjermani, Faruk Ajeti.



Ministri Latifi thotë se është gati për miratim Ligji për Sigurimin Shëndetësor

PRISHTINË, 29 PRILL (ER) - Kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), Atdhe Hykolli, bashkë me anëtarin e kryesisë së BSPK-së, Ymer Ymeri, është takuar me ministrin e Shëndetësisë, Rifat Latifi. Qëllimi i takimit ishte ndërlidhur me kërkesat e BSPK-së të cilat i janë

parashtruar partnerit social - qeverisë. Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, e ka njoftuar kryetarin Hykolli se grupi punues i Ministrisë së Shëndetësisë është duke përgatitur Ligjin për Sigurimin Shëndetësor dhe pritet që gjatë muajt në vijim të dërgohet për miratim. Latifi e ka ftuar kryetarin e

BSPK-së që t'i propozojë anëtarët e grupit punues nga radhët e BSPK-së për të marrë pjesë në përgatitjen e ligjit. "Dialogu i sotëm u vlerësua i suksesshëm dhe i duhur nga partnerët socialë, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe Ministria e Shëndetësisë", ka njoftuar BSPK-ja.



Kinematografia dhe rrënjët historike të multiversit

Kritiku i filmit në BBC, Nicholas Barber, shkruan për idenë e multiverseve në kinematografi. Pjesë të shkruimit të tij, Telegrafi sjell si më poshtë.

A e mbani mend kur shpëtimi i botës mjaftonte për çdo personazh filmi? Këto ditë duhet të bëjnë më shumë. Te filmi i vitit 2019, “Avengers: Endgame”, heronjtë më të fuqishëm të Tokës shkuan aq larg sa e shpëtuan Universin. E, në vitin 2022, superheronjtë pritet ta gjejnë rrugën reth një labirinti të tërë universesh të ndryshme. Ky është Multiversi.

Ky është koncepti qendror i dy filmave të fundit të Spider-Manit. Fillimisht ishte filmi i animuar i vitit 2018, “Spider-Man: Into the Spider-Verse”, që i paraqiti ekuivalentët e Spider-Manit prej universeve të ndryshme alternative, si Spider-Ham dhe Spider-Man Noir. Pastaj ishte aksioni i vitit të kaluar, “Spider-Man: No Way Home” që i paraqiti tre aktorë të ndryshëm që në periudha të ndryshme përgjatë 20 vjetëve të fundit e kanë luajtur si Peter Parkers njeriun merimangë – Tom Holland, Andrew Garfield dhe Tobey Maguire. Dhe, tash vjen “Doctor Strange in The Multiverse Of Madness”.

Multiverset janë pjesë e bisedave, kështu që ku po shkon Toka (ose Tokët)?

Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje, duhet të ktheheni te diskutimet e realiteteve tjera, që në filozofinë e lashtë greke dhe në mitologjinë hindu e atë persiane. Shumë libra merren gjithashtu me dy ose më shumë realitete: për shembull “The Chronicles of Narnia” nga CS Lewis. Por, nocioni i universeve të panumërta bashkekzistuese u parashtrua si mundësi shkencore në vitin 1957 – nga Hugh Everett, matematikan nga Uashingtoni.

Peter Byrne e përshkruan interpretimin e mekanikës kuantike të “shumë botëve” të Everetti, në biografinë “The Many Worlds of Hugh Everett III”. “Everetti e formuloi zgjidhjen për një problem në teorinë kuantike, për problemin e matjes. Thënë më thjesht, problemi lind sepse, logjikisht, një grimcë atomike të njëjtën kohë mund të lëvizë nëpër hapësirë dhe në kohë – sikur të jetë një valë sferike që zgjerohet dhe kalon nëpër të gjitha trajektorët e mundshme. Por, kur bashkëveprojmë me grimcën – kur e matim atë – e gjejmë gjithmonë në një vend, e jo në shumë vende ... Everetti tregoi se është matematikisht e qëndrueshme të thuhet se kur një shkencëtar mat pozicionin e një grimce atomike, ai ndahet në kopje të shumta të vetvetes. Çdo kopje rri në univers të ndryshëm. Dhe, çdo kopje e shihet



grimcën në pozicion të ndryshëm. Grupi i të gjitha kopjeve mbulon grupin e të gjitha pozicioneve të mundshme të grimcave brenda një multiuniversi. Sipas Everetti, secili univers brenda multiversit degëzohet vazhdimisht si pemë në botë të veçanta, por në paralele që nuk mund të komunikojnë me njëra-tjetrën ... Pasoje e logjikës së ‘shumë botëve’ është se ka universe në të cilat dinosaurët mbijetuan dhe njerëzit mbetën si minj; universe në të cilat çdo javë e fiton lotarinë shtetërore; universe në të cilat Wall Street-i nuk ekziston dhe burimet globale ndahen në mënyrë të barabartë. Dhe, me sa duket, universet në të cilat Peter Parker ende duket si Tobey Maguire e jo si Tom Holland.

Punimi i Everetti, vazhdon Byrne, “u hodh poshtë nga shumica e instituteve të fizikës”, kështu që kaloi në hulumtimin e operacioneve ushtarake.

Por, nëse shkencëtarët nuk ishin të bindur me vizionin e Everetti, autorët e fantashkencës u frymëzuan prej tij. Njëri prej tyre ishte Michael Moorcock nga Britania e Madhe, i cili solli termin “multivers” në kulturën popullore nëpërmjet romanit “The Sundered Worlds” të vitit 1963. “Ishte ide në ajër, siç janë shumica e tyre”, ka thënë Moorcock, “dhe hasa në një referencë në revistën ‘New Scientist’ (një nga miqtë e mi më të mirë atëherë ishte redaktor) ... ose miqtë fizikanë më folën për të. Ajo që ndodh është se ju i imagjinoni këto gjëra në kontekstin e letërsisë, ndërsa fizikanët dhe matematikanët i imagjinojnë ato në aspektin shkencor”.

Autorët i imagjinonin këto gjëra edhe në kontekstin e stripave. Në

vitin 1940, DC nisi ta publikonte strupin “The Flash”, një superhero i shpejtë emri i vërtetë i të cilit ishte Jay Garrick. Në vitin 1951, seria e këtyre stripave u pezullua dhe kur personazhi u “ringjallë” në vitin 1956, iu dha kostumi i ri dhe alter egoja e re, Barry Allen. Ky Flash i ri madje u shfaq duke e lexuar një strip për paraardhësin e vet, duke vërtetuar kështu se, sa i përket Allenit, Garricku nuk ishte gjë tjetër veçse një personazh imagjinari, megjithëse një personazh imagjinari me të cilin kishte shumë të përbashkëta. Më pas, në një histori të botuar në vitin 1961, Alleni u fut në një realitet tjetër ku ishte ballë për ballë me Garrickun. Flashi aktual (Allen) jetonte në Earth-One, ndërsa i vjetri (Garrick) në Earth-Two, bashkë me të gjithë superheronjtë e tjerë nga e ashtuquajtura “Epoka e Artë” e DC-së e viteve 1930 dhe 1940.

Lexuesit e pëlqyen këtë gjë dhe DC botonte stripe me epike nga Epokën e Artë dhe nga Epoka e Argjendit e Ligës së Drejtësisë të Amerikës. Më pas, në vitin 1964, një nga redaktorët e DC-së, Julius Schwartz, pati një ide. Nëse janë dy Toka, arsyetoi ai, pse të mos jetë një të tretë, një univers ku superheronjtë ishin superkeqberës dhe ku Liga e Drejtësisë e Amerikës ishte Sindikata e Krimeve të Amerikës? Kështu, Earth-Three iu bashkua lojës.

Multiversi i DC-së vazhdoi të rritej, meqë autorët e përdorën konceptin për të sjellë personazhe tjera të kompanive tjera që DC i kishte blerë, për të rrëfyer histori që nuk përshtaten me Earth-One. Kështu, multiversi u bë aq i famshëm sa që kompania e publikoi një mini-seri me 12

numra në 1985, të quajtur “Crisis on Infinite Earths” në të cilën çdo realitet u fshi, përveç njërit. Por, kjo nuk zgjati shumë, derisa më 2014 dhe 2015 u krijua mini-seria e re e shkruar nga Grant Morrison, “The Multiversity”, që e përfshinte një hartë të multiverseve të DC-së dhe një udhëzues për 52 universe. “Çdo botë paralele i ka historitë dhe personazhet e veta të reja dhe secila në thelb mund të formojë bazën për një seri të tërë stripash të rinj”, ka thënë Morrison

Koncepti mori hov edhe në prozën artistike. Romani “The Dark Tower” i Stephen Kingut sillet reth një multiversi, përfshirë “All World”, “Prime Earth” dhe botën ku Kingu e shkruan “The Dark Tower”. Por, në përgjithësi, ideja ka qenë shumë e shtrenjtë dhe shumë e ndërlikuar për kinemanë. Kështu, shumica e filmave që kërcenin në dimensione tjera – si “Back to the Future” apo “Sliding Doors” – kufizohen në disa universe të caktuara.


Duke filluar me filmin “Iron Man” më 2008, të gjithë filmat e Marvel-it janë vendosur në të njëjtin “univers që bashkërisht përdoret”, ashtu siç kanë qenë gjithmonë të gjitha stripat e kompanisë. Hulku mund të shfaqet në një film “Iron Man”, Thori mund të shfaqet në ndonjë film “Captain America” dhe ... “Avengers” mblidhen.

Deri tash, universi që bashkërisht përdoret ishte i rrallë në kinema, por seria Marvel Cinematic Universe ka qenë sukses i madh. Publiku është i lumtur kur ngatërrohet në rjetën e rrëfimeve të ndërlikdhura. Kështu, nëse një korporatë mund të marrë të drejtat për ekranizim të Batmanit, Supermanit ose Spider-Manit, mund t’i emocionojë adhuruesit

duke i futur në të njëjtin film. Kjo do të thotë se universi i përbashkët mund të përparojë në multivers. Ndaj, personazhet e njohura nga universet imagjinare të filmave “Harry Potter” dhe “The Matrix” mund të ftohen në filmin “The Lego Batman Movie”.

Filmat me multiverse i kujtojnë lojërat dhe bisedat tona të fëmijërisë, në të cilat ne (ose gjigantët mes nesh, gjithsesi) mendonim nëse Han Solo mund të dilte të shfaqej te seria “Indiana Jones”. Ku ka mbetur për të shkuar? Kjo sot mund të jetë përgjigje ndaj ndjenjës aq shpesh të shprehur në mediat sociale, se realiteti ynë është absurd dhe distopian dhe se duhet të ketë një kronologji më të mirë diku. Mund të jetë gjithashtu përgjigje ndaj mbingarkesës së informacionit të internetit dhe ndjenjës se universet e pallogaritshme po konkurrojnë për vëmendjen tonë sa herë që ne këqemi. Ky sigurisht ishte një nga mendimet që e krijoi filmin “Everything Everywhere All at Once”. “Donim që filmi të lidhej me atë që është si të lëvizësh me maus në një sasi të pafundme gjerash”, tha Daniel Scheiner, “që është diçka që të gjithë e bëjmë”.

Sidoqoftë, se si kanë vepruar stripat, ka ende botë për të hulumtuar. Kështu që mund të ndodhë që kompania Disney (që është pronare e superheronjëve të Marvelit) të bashkëpunojë me kompaninë Warner Bros (pronare e superheronjëve të DC-së) dhe personazhet e Marvelit si Doctor Strange, Hulk apo Spider-Man të lidhen me Batmanin e Supermanin e DC-së. Nëse nuk ndodhë në këtë univers, do të ndodhë në tjetrin! /Telegrafi/



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Distria fiton medaljen e bronzë në Kampionatin Evropian



PRISHTINË, 29 PRILL - Xhudistja nga Kosova, Distria Krasniqi, e ka fituar medaljen e bronzë në Kampionatin Evropian që po mbahet në Bullgari. Të premtën Krasniqi fitoi ndaj gjermanes Mascha Ballhaus vetëm pas "Golden Score", ku u deshën mbi gjashtë minuta për ta përcaktuar fituesin. Distria rrethin e parë e kaloi pa

luftë, kurse në rrethin e dytë mposhti Gabriela Dimitrova me IPPON. Në çerekfinale u mposht nga nënkampionia olimpikë Amandine Buchard në "Golden Score". Krasniqi bëri tri gabime, përmes të cilave edhe u njoftua me humbjen. Krasniqi e vazhdoi garimin dhe e synoi medaljen e bronzë përmes repesazhit.

Në ndeshjen e parë të repesazhit ajo mposhti Fabienne Kocher të Zvicrës. Të premtën ka garuar edhe xhudistja e re nga Kosova, Flaka Loxha, e cila është eliminuar në çerekfinale dhe më pas është mposhtur në duelin e parë të repesazhit. Sot (e shtunë) garojnë Akil Gjakova dhe Laura Fazliu.

Sonte përballen Bashkimi - Peja, nesër Prishtina - Prizreni 16

PRISHTINË, 29 PRILL - Në fundjavë do të zhvillohen ndeshjet e dyta çerekfinale të "play-off"-it në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll. Në ndeshjet e para fituan Peja dhe Prizreni 16, ndërsa skuadra që shënon dy fitore kualifikohet në gjysmëfinale. Të shtunën do të përballen Bashkimi dhe Peja, dy skuadra me traditë në basketbollin e Kosovës. Pejanët fituan sfidën e parë 94:70 dhe prizrenasit duhet ta fitojnë

ndeshjen e dytë në mënyrë që fituesi të vendoset në takimin e tretë. Nëse verdhezinjtë shënojnë fitore, atëherë do të kualifikohen në gjysmëfinale, ku i pret Trepça, që u rendit e dyta në garat e rregullta. Përballja tjetër është mes Prizrenit 16 dhe Sigal Prishtinës. Prizrenasit shënuan fitore në ndeshjen e parë 95:87, ku herë njëra skuadër kalonte në epërsi e herë tjetra. Sfidat e dytë pritet të jetë interesante me

prishtinasit që kërkojnë fitoren për ta barazuar serinë çerekfinale dhe prizrenasit që duan gjysmëfinalen, ku i pret lideri dhe kampioni Golden Eagle Ylli.

Çerekfinalat

Të shtunën takohen:
20:45 Bashkimi - Peja

Të dielën takohen:
17:00 Sigal Prishtina - Prizreni 16



Rahoveci apo Prishtina e Re në Superligë

PRISHTINË, 29 PRILL - Sonte (e shtunë) do të zhvillohet ndeshja e dytë e "play-out"-it ndërmjet Rahovecit dhe Prishtinës së Re. Në takimin e parë të zhvilluar në kryeqytet fitore shënuan prishtinasit me rezultat 93:89, duke i befasuar të gjithë. Kryeqytetasit përfunduan garat në vendin e dytë të Ligës së Parë si dhe ishin finalistë të "play-off"-it, ku pësuan nga Vëllaznimi i Gjakovës, që siguroi një vend në Superligë, ndërsa rahovecasit u renditën në vendin e shtatë të elitës, duke garuar në "play-out".

Takimi i parë ishte shumë i barabartë, ndërsa ndeshja e dytë do të jetë vendimtare se kush do të sigurojë një vend në Superligë për edicionin e ardhshëm. "Vreshtarët" duhet të shënojnë fitore me më shumë se katër pikë dallim në mënyrë që të mbesin pjesë e elitës së basketbollit, kurse nëse prishtinasit fitojnë ose pësojnë humbje të ngushtë, atëherë për herë të parë do të garonin në Superligë.

Të shtunën takohen:
20:30 Rahoveci - Prishtina e Re

Sonte finalja e parë në mes të Besës dhe Prishtinës

PEJË, 29 PRILL - Besa Famgas e Prishtina janë në finale të "play off"-it në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt). Skuadra që shënon dy fitore apo që fillimisht shënon një fitore e një barazim, shpallet kampione. Ndeshja e parë finale luhet të shtunën mbrëma me fillim nga ora 20:30 në palestrën "Karagaçi" në Pejë. Besa Famgas gjatë stinorit të rregullt nuk ka pasur konkurrencë. I ka fituar të gjitha 28 ndeshjet. Në gjysmëfinale të "play off"-it pa telashe e kaloi

Rahovecin pas dy ndeshjeve. Prishtina ishte e dyta me bilanc prej 22 fitoresh, një barazim e pesë humbje. Në gjysmëfinale të "play off"-it prishtinasit e kaluan Trepçën, po ashtu pas dy ndeshjeve. Forma e Prishtinës në gjysmëfinale ishte më e mirë se në stinorin e rregullt dhe te kjo skuadër shpresojnë për ngritje të mëtejme të nivelit në ndeshjet finale ndaj Besës. Dy skuadrat në përbërje kanë plot reprezentues të Kosovës, andaj pritet shfaqje e bukur hendbolli.



Ermal Krasniqi për herë të tretë fiton çmimin 'ylli i javës'

PRISHTINË, 29 PRILL - Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsoren e Superligës, Bankën Kombëtare Tregtare, BKT Kosova, vazhdojnë të japin çmimin "ylli i javës" për lojtarin më të mirë të xhiros. Këtë çmim për xhiron e 31-të e ka fituar futbollisti i FC Ballkani, Ermal Krasniqi. Për 23-

vjeçarin e portokallezjinve nga Suhareka kjo është hera e tretë brenda këtij edicioni që e fiton këtë çmim, por hera e parë në stinorin pranveror. Ai ishte shpallur më i miri edhe në xhiron e 2-të dhe në xhiron e 11-të. Krasniqi ishte ndër lojtarët më të mirë të këtij edicioni dhe një

paraqitje mbresëlënëse e pati edhe në ndeshjen kundër Dritës (3-2). Ai ishte kreator i golit të parë si dhe realizator i golit të tretë, në minutat shtesë, duke qenë përcaktues në arkëtimin e tri pikëve të reja, të cilat e kanë afruar Ballkanin te titulli i parë i kampionit.



Dajaku: Ky vendim thyen çdo ligj të shtetit të Kosovës

PRISHTINË, 29 PRILL - Për shkak të, siç thuhej, fyerjeve e shpifjeve ndaj Federatës së Futbollit të Kosovës, Komisioni Disiplinor i këtij institucioni largoi nga puna e dënoi tre zyrtarë të futbollit vendas. Një ndër ta ishte edhe drejtori sportiv i skuadrës së Drenicës, Taulant Dajaku, i cili u gjobit me 200 euro dhe iu ndalua ta ushtronte detyrën e tij te skuadra nga Skenderaj për gjashtë muaj. Siç thuhej në vendimin e FFK-së, Dajaku kishte shpifur dhe fyer shtëpinë e futbollit të Kosovës, konkretisht në intervistën e dhënë në emisionin "Interaktiv" të KTV-së.



Në arsyetimin e vendimit të marrë thuhet se ish-mesfushori nuk ka ofruar prova për t'i mbështetur deklaratimet e bëra në televizion. Dajaku për "Lajmi.net" ka thënë se nuk bëhet fjalë për kurrfarë shpifje ose fyerje ndaj FFK-së siç pretendohet në vendim. "Është lehtësisht e konstatueshme se çdo opinionimi imi, në asnjë vend, s'ka asnjë fyerje, asnjë dezinformim dhe

asgjë të dënueshme mbi bazat kushtetuese të këtij vendi. Krejt çka kam thënë është këndvështrimi im për gjërat që po ndodhin", ka thënë Dajaku. "Vendimi dhe arsyetimi janë krejtësisht të pabazë. Ky vendim tregon saktësisht se në çfarë gjendje është futbollit i Kosovës tashmë. Ky vendim thyen çdo ligj të këtij shteti pasi cenon të drejtën e individit për t'u shprehur lirshëm. Mbi të gjitha, po tentohet të indimidohen njerëz dhe të vendoset diktat në çdo gjë në

futbollin e Kosovës", ka shtuar ai. Dajaku nuk paralajmëroi ankesë ndaj këtij vendimi, përkundër që, siç shprehet, është krejtësisht i pabazë. Njëjtë sikurse Dajaku pësoi edhe një tjetër drejtor sportiv. Bëhet fjalë për Valon Zymerin e Dritës që, po ashtu, u dënua me 200 euro dhe gjashtë muaj mospunë. Më së keqi nga të dënuarit e pësoi sekretari i përgjithshëm i FFK-së, Eroll Salihu, që u largua nga puna për të njëjtat arsye.

Përcaktohen gjysmëfinalët në Lindje, avancojnë edhe Phoenixi dhe Dallasi



DALLAS, 29 PRILL - Janë përcaktuar katër skuadrat gjysmëfinaliste të "play-off"-it në Konferencën e Lindjes. Philadelphia është ekipi i fundit që shkon në katërshë, pas fitores 132-97 arritur ndaj Torontos në Kanada, duke fituar 4-2 serinë e takimeve. Të gjithë titullarët e Philadelphia realizuan mbi 12 pikë, me Joel Embiid që bëri dallimin, me 33 pikë e 10 rebounde (Maxey 25 pikë e

Harden 22). Në Perëndim skuadra e Phoenixit mposhti 115-109 New Orleansin dhe fitoi 4-2 serinë e çerekfinaleve, duke shkuar në gjysmëfinale. Ndeshje me rivalitet, ku për Sunsin u dallua veterani Chris Paul me 33 pikë. Në gjysmëfinale shkoi edhe Dallasi, që mundi në sekondat e fundit 98-96 Utah Jazzin. Doniqi e Brunsoni realizuan nga 24 pikë secili për Dallasin, duke i bërë të

KONFERENCA E LINDJES - ÇEREKFINALE "PLAY-OFF"		
Miami - Atlanta	(4-1)	
Philadelphia - Toronto	132-97 (4-2)	
Milwaukee - Chicago	(4-1)	
Boston - Brooklyn	(4-0)	
KONFERENCA E LINDJES - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"		
Miami - Philadelphia		
Boston - Milwaukee		
KONFERENCA E PERËNDIMIT - ÇEREKFINALE "PLAY-OFF"		
Phoenix - New Orleans	115-109 (4-2)	
Dallas - Utah Jazz	98-96 (4-2)	
Golden State - Denver	(4-1)	
Memphis - Minnesota	(3-2)	
Konferenca e Perëndimit - Gjysmëfinale "play-off"		
Phoenix - Dallas		
Golden State - ?		

pavlefshme 23 pikët e Mitchellit për vendasit.

SHKURT

Mourinho: Finalja do të jetë në Romë, jo në Tiranë

Roma ka barazuar me Leicester Cityn (1-1). Ky rezultat final lë gjithçka të hapur për ndeshjen e kthimit që zhvillohet në stadiumin "Olimpico". Trajneri Jose Mourinho ka thënë se finalja për skuadrën e tij do të zhvillohet në Romë dhe jo në Tiranë, duke aluduar se ndeshja kthye do të jetë shumë e rëndësishme. "Finalja do të jetë në Romë, jo në Tiranë. Do të jetë shumë bukur. Nëse do ta luanim këtë ndeshje disa muaj më parë do ta kishim humbur. Ky barazim është i pranueshëm. Tifozët kanë firmosur për një finale, por unë nuk buzëqesh, pasi më duhet të mendoj edhe për Bolognan. Dëshiroj ta siguroj praninë në Ligën e Evropës nga Seria A pa pritur në Ligën e Konferencës", ka thënë Mourinho.

Salahu fiton çmimin 'futbollisti i vitit' në Angli

Mohamed Salah u votua "futbollisti i vitit" nga Shoqata e Gazetarëve të Futbollit, një çmim vjetor që ka nderuar lojtarët më të mirë të Premierë Ligës që nga viti 1948 sipas shtypit anglez. Ky është çmimi i dytë për sulmuesin e Liverpoolit, kur hera e parë ishte në sezonin 2017/2018. Me 48 % të votave mund konkurrencën e De Bruyne dhe Declan Rice, përkatësisht në vendin e dytë dhe të tretë. Ndërsa për femrat këtë çmim e mori sulmuesja e Chelseas, Sam Kerr.

Rangnick emërohet trajner i Austrisë

Ralf Rangnick është trajner i ri i Austrisë. Ky ishte një lajm që qarkullonte prej ditësh në ishull, por tashmë është bërë zyrtarë nga vetë federata austriake. Tekniku gjerman ka firmosur një kontratë dyvjeçare, por në të njëjtën kohë do të vijojë të jetë i punësuar edhe në "Old Trafford". Rangnick, në bazë të kontratës të firmosur në fillim të këtij viti, do ta mbajë pozitën e këshilltarit në klub. Rangnick do të qëndrojë në drejtimin e "djajve të kuq" deri në përfundim të këtij sezoni për t'i lëshuar bankinën me Eric Ten Hag.

Federeri konfirmon pjesëmarrjen në turneun e Baselit

Tenisti zviceran Roger Federer ka konfirmuar se do të rikthehet të luajë në turneun e shtëpisë, atë të Baselit, që do të zhvillohet në tetor të këtij viti. Ky turne nuk u zhvillua dy vjetët e fundit për shkak të pandemisë, por tashmë është pjesë e kalendarit të ngjarjeve dhe të Federerit. Roger Federer, ish-numri një në botë, e ka fituar 10 herë këtë turne dhe, së fundi, ka zyrtarizuar praninë e tij në Basel. Shitja e biletave për këtë turne ka nisur që dje dhe pas lajmit të pjesëmarrjes së Federerit, fansat e tij kanë nisur të prenotojnë që tani një vend për ta parë. Federeri nuk luan që prej korrikut të vitit të kaluar dhe këtë vit do të festojë 41-vjetorin e lindjes. Ai ka kohë që vijon fazën e rikuperimit dhe nuk ka dhënë një datë të saktë se kur do ta luajë ndeshjen e parë zyrtare. Turneu i Baselit i fituar në vitin 2019 është i fundit në karrierën e Federerit (103 turne të fituara).

'Topi i Artë' është arsyeja pse Lewandowski dëshiron të largohet nga Bayerni

E ardhmja e sulmuesit polak të Bayern Munchenit, Robert Lewandowski, do të jetë në një kampionat tjetër. Në Spanjë e kanë shpjeguar vendimin e marrë nga

sulmuesi. Sipas "Sport.es", në fakt, mes arsyeve që duket se e kanë shtyrë Lewandowskin të largohet nga Bavaria është edhe përshtypja se nuk mund ta

fitojë "Topin e Artë" duke qëndruar në Gjermani. Media spanjolle ka nënvizuar se nëse do të hamendësohej një moment në të cilin polaku ka

vendosur të largohet nga Bayerni, ai do të ishte dita kur nuk ka arritur ta fitojë "Topin e Artë" 2021, një çmim i fituar nga Lionel Messi. 33-vjeçari duket se

është bindur se, përtej statistikave të tij dhe fitoreve me klubin, nuk do ta fitojë kurrë trofeun prestigjioz duke qëndruar me klubin e Bundesligas.



Shoqata Humanitare Bëmirese e Kosovës "Nëna Tereze"
The Kosovo Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"
Humanitarno Dobrotvorna Udruženje Kosova "Majka Tereza"
10 000 Prishtinë, Rr. ULPIANA U1/1 po. Tel:00381 38 542 864, Fax:542 869,
Web site: www.ansh.org e-mail:ntereze@yahoo.com

NJOFTIM PËR DHËNIE TË KONTRATËS SHËRBIME

Sipas Nenit 41 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 29/04/2022

Nr i Prokurimit	Transporti	001	2022	221
-----------------	------------	-----	------	-----

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip

NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar Shoqata Humanitare Bëmirese e Kosovës "Nëna Tereze"		
Adresa Postare: Mujë Krasniqi Ulpiana U1/1		
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Zef Shala		Telefoni: 044-128-277
Email: zefshala@hotmail.com		Faksi: 038-542-869
Adresa e Internetit (nëse aplikohet):		www.motherteresasociety.org

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët Jo

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit Jo

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Shërbime të transportit Ndërkombëtar
II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit (Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime - e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)
<input type="checkbox"/> Shërbime
Vendi kryesor i realizimit Sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues ORADEA Hungari
II.1.3) Njoftimi përfshinë, nëse aplikohet Kohëzgjatja e marrëveshjes kornizë: në muaj 30 ditë (një muaj)_
II.1.4) Përshkrimi i shkurtër i lëndës së kontratës Transporti i ndihmave Humanitare per nevoja të popullatës së Ukrainës të qvendosur në Rumani
II.1.5) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP) 60.00.00.00-8
II.1.6) Ndarja në Pjesë Jo <input type="checkbox"/>
II.1.7) Vlera e parashikuar e kontratës: 15,000.00 Euro

NENI III: PROCEDURA

III.1) LLOJI I PROCEDURËS

E hapur

III.2) KRITERET E DHËNIES

Çmimi më i ulët

III.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

III.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë
Njoftimi për kontratë

SECTION IV: DHËNIA E KONTRATËS

(Në rast të disa pjesëve të dhëna disa operatorëve ekonomik të suksesshëm, përsërit S IV.4 dhe IV.5 për secilën pjesë)

IV.1) Data e dhënies së kontratës 29 /04/2022		
IV.2) Data e planifikuar e nënshkrimit të kontratës 04/05/2022		
IV.3) Numri i tenderëve të pranuar 2		
IV.4) Emri dhe adresa e operatorit ekonomik, të cilit i është dhënë kontrata		
Emri zyrtar: AGRO-AB SHPK Graçanicë		
Adresa Postare: Qagllavicë-Graçanicë		
Qyteti: Graçanicë	Kodi postar: 10000	Vendi: Xhemi Shija Qagllavicë
URL (nëse aplikohet):		
Personi kontaktues: Alush Bendi		Email:
Telefoni: 00381603630163		Faksi:

IV.5) Informacione mbi vlerën e kontratës

Vlera e përgjithshme e kontratës 15,000.00 Euro

Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët: 15,000.00 Euro

Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lartë: 16,000.00 Euro

IV.6) A ka gjasa që kontrata të nënkontraktohet Jo

IV.1) Data e dhënies së kontratës 29/04/2022		
IV.2) Data e planifikuar e nënshkrimit të kontratës 04/05/2022		
IV.3) Numri i tenderëve të pranuar 2		
IV.4) Emri dhe adresa e operatorit ekonomik, të cilit i është dhënë kontrata		
Emri zyrtar: AGRO AB SHPK		
Adresa Postare: Qagllavicë Xhemi Shija		
Qyteti: Graçanicë	Kodi postar: 10000	Vendi Qagllavicë- Graçanicë
URL (nëse aplikohet):		
Personi kontaktues: Alush Bendi		Email:
Telefoni: 00381603630163		Faksi:
IV.5) A ka gjasa që kontrata të nënkontraktohet Jo <input type="checkbox"/>		

SECTION V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues në bazë të nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në Nenin I të këtij Njoftimi për dhënie të kontratës.

V.2) INFORMACIONET SHITESË

Shto informacione tjera:

Shtojcë: Kopja e deklaratës së Nevojave dhe Disponueshmërisë së mjeteve

Formulari Standard: "Njoftimi për dhënie të kontratës"

3

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Violeta Gashi shpall të pavlefshme diplomën, tri dëftesat e notave të SH.M.M. "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë, si dhe Licencën e Punës të Lëshuar nga MSH-ja, me nr. KO-24474-05-22.
- Besim Fazliu shpalle te pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHMLT :Arkitekt SINANI".
- Suela Dibrani shpalle te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Jusuf Rexha".
- Halil Sylejmani B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810345274 .
- Gresa Roka nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e Sh.F.M.U 'Yll Morina' nga klasa –VI-IX.
- Suhejb Ibra shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Eqrem Çabej" nga klasa 6-9.
- Edmond Dodaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme teknike "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Zymer Morina shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.
- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Ergin Karaali shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Kadri Hoxha shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "ARKITEKT SINANI".
- Fahri Ibishi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani".
- Valjeta Thaqi shpall te pavlefshme diplomën SHME " Ymer Prizreni" Prizren.
- Driton Musliu shpalle te pavlefshme dëftesën e vitit të I dh të VI të SHMLT "ARKITEKT SINANI".
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Driton Musliu shpalle te pavlefshme dëftesat e vitit të II dhe të III dhe diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani".



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

